



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 547 Prot.

Tiranë, më datë 02.06.2022

VENDIM
Nr. 184, datë 02.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 58, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 02.06.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit Kërkimor Shkencor në vazhdim “Bazilika paleokristiane jashtë mureve, Elbasan” me drejtues teknik Elio Hobdari, me aplikues dhe zhvillues Akademia e Studimeve Albanologjike;
2. Pas përfundimit të projektit një kopje e dokumentacionit si dhe lista e gjetjeve arkeologjike të depozitohen pranë IKTK –së;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

